

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7829  
E hënë, 8 korrik 2024  
Çmimi 0.50

## A mund të ndalohet përdorimi i TikTok-ut në Kosovë? | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ISH-DREJTORI I RTK-së THOTË SE DHA DORËHEQJE PËR SHKAK TË 'PRESIONIT POLITIK'

FAQE 4-5



Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, Shkumbin Ahmetxhekaj, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Pas dorëheqjes së tij, Bordi i RTK-së ka emëruar ushtruese detyre të drejtoreshës së përgjithshme,

Zana Spahiun, Ahmetxhekaj në "Facebook" ka thënë se vendimi për dorëheqje ka ardhur si rezultat i një presioni politik dhe se nuk është akt dorëzimi i tij. Asociacioni i Gazetarëve të

Kosovës (AGK) ka ndjekur me shqetësim të thellë zhvillimet e muajve të fundit në RTK, që kanë rezultuar të dielën me largimin e Shkumbin Ahmetxhekajt nga pozita e drejtorit të përgjithshëm

## ISH-INSPEKTORI I AKI-së: MUNGESA E SIGURISË PUBLIKE PO KËRCËNON JETËN E QYTETARËVE | F.4



## HARADINAJ E QUAN 'MASHTRUES ORDINER' KURTIN | F.3



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## AKTUALE



BE-ja DISTANCOHET PËRSËRI NGA ORBANI PAS PJESËMARRJES SË TIJ NË SAMITIN E VENDEVE TURK-FOLËSE | F.2

"OBLIGIMET PËR KOSOVËN DHE SERBINË NGA DIALOGU S'NDRYSHOJNË ME LEHTËSUESIT E RINJ" | F.5

KËRKOHET SHTATORE PËR ISH-TË BURGOSURIT POLITIKË | F.6

## EKONOMI



MINISTRI I BUJQËSISË U DËRGON MESAZH KRITIKUESVE: KUR S'KA HAJNI, ZOTI DËRGON BEGATI! | F.7

LIGJI I RI PËR PROCEDURAT E ATK-SË, GËRXXHALIU: DISKRIMINUES PËR EKZISTENCËN E NVM-ve NË KOSOVË | F.7

## SPORT



XHAKA: NUK E MERITONIM TË HUMBIM KËSHTU | F.10

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Erdogani thotë se mund ta ftojë Assadin në Turqi “në çdo moment”

ANKARA, 7 KORRIK - Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, tha të dielën se mund ta ftojë homologun e vet sirian Basharal-Assad për vizitë në Turqi “në çdo moment”. Kjo është një shenjë se mund të ketë pajtim në mes të Ankarasë dhe Damaskut, pasi marrëdhëniet mes tyre u prishën pas luftës së vitit 2011. “Ne mund t’ia dërgojmë atij [Assadit] ftesën në çdo moment”, tha Erdogan për gazetarë në avionë duke u kthyer nga Berlina, ku qëndroi për ta përcjellë Euro 2024, raportuan agjencia zyrtare e lajmeve Anadolu dhe medie të tjera. Turqia fillimisht synoi ta rrëzonte regjimin e Assadit kur shpërtheu konflikti sirian me shtypjen e dhunshme të protestave civile në vitin 2011. Por, megjithëse

mbështeti grupe të ndryshme të armatosura, Ankaraja së fundmi ndryshoi qëndrim dhe tani është e përqendruar në, siç Erdogan e përshkroi më 2019, parandalimin e hapjes së një “korridorit të terrorit” në veri të Sirisë. Ka kohë që Erdogan thotë se mund t’i shqyrtojë ndreqjen e marrëdhënies me Assadin. “Tani kemi ardhur në një pikë që, sapo Basharal-Assad të ndërmarrë hapa drejt përmirësimit të marrëdhënies me Turqinë, ne do ta shfaqim qasjen e tij”, tha Erdogan. Turqia ka tentuar t’i përmirësojë raportet me Sirinë teksa qeveria po përballet me presion brenda vendit për të riatdhesuar miliona refugjatë sirianë që gjenden në Turqi.



## BE-ja distancohet përsëri nga Orbani pas pjesëmarrjes së tij në samitin e vendeve turkfolëse

BRUKSEL, 7 KORRIK - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, është qortuar përsëri nga shefi i Bashkimit Evropian (BE) për politikë të jashtme, Josep Borrell, pasi mori pjesë të shtunën në një takim të Organizatës së Vendeve Turkfolëse (OTS) në Azerbajxhan. Ditë më parë Brukseli, vendet e BE-së, Shtetet e Bashkuara dhe Kievi e kritikuan Orbanin pas vizitës së tij në Moskë, ku u takua me presidentin rus Vladimir Putin të premtën.



Orbani e takoi Putinin një kohë kur Hungaria mban kryesimin me rotacion gjashtëmuor të presidencës së Këshillit të BE-

së. Zyrtarët e BE-së e kritikuan ashpër vizitën e tij befasuese, duke thënë se ajo kërcënon ta

minojë qëndrimin e BE-së për luftën në Ukrainë dhe thanë se Orbani nuk shkoi atje si përfaqësues i Brukselit.

Pjesëmarrja e Orbanit në samitin joformal të OTS-së në Azerbajxhan të shtunën ishte një ngjarje tjetër ku ai e përfaqësoi Hungarinë dhe jo Bashkimin Evropian, tha Borrelli. “Hungaria nuk ka marrë mandat nga Këshilli i BE-së për t’i shtyrë përpara marrëdhëniet me Organizatën e Shteteve Turkfolëse”, tha Borrelli në një komunikatë.

Orbani është fjalosur me Brukselin për vizitat e tij kundërthënëse. “A nuk lejohemi të kemi darkë, apo kemi nevojë për një mandat të EUCO [Këshilli i BE-së] edhe këtë?” shkroi drejtori i tij politik në X pas vizitës në Moskë.

BE-ja i ka kundërshtuar

përpjekjet e OTS-së për ta legjitimuar Republikën Turke të Qipros Veriore duke e pranuar si anëtare vëzhguese, tha Borrelli. Ishulli i Qipros është i ndarë tash e shumë dekada në mes të Republikës së Qipros grekfolëse, e njohur ndërkombëtarisht, e cila është edhe anëtare e BE-së, dhe Republikës Turke të Qipros Veriore turkfolëse, e njohur vetëm nga Ankaraja.

OTS-ja është organizatë ndërkombëtare që sjell së bashku vendet ku flitet turqishtja. Ajo u themelua më 2009 nga Turqia, Azerbajxhani, Kazakistani dhe Kirgistani.

Hungaria u bë anëtare vëzhguese e saj në vitin 2018.

## Protestuesit izraelitë bllokojnë rrugët, kërkojnë lirim dhe pengjeve dhe armëpushim

JERUSALEM, 7 KORRIK - Protestuesit izraelitë kanë bllokuar autostrada nëpër vend të dielën, duke i bërë thirrje kryeministrit Benjamin Netanyahu të japë dorëheqje dhe të bëjë trysni për një armëpushim për lirim dhe pengjeve që po mbahen në Gazë nga Hamasi - grup i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Demonstratat u mbajtën një ditë pasi ndërmjetësit ndërkombëtarë i ripërtërinë përpjekjet për ta ndërmjetësuar një marrëveshje në mes të Izraelit dhe Hamasit.

Të shtunën Hamasi e dha pëlqimin fillestar për një propozim amerikan për një marrëveshje për armëpushim në Rripin e Gazës, pasi hoqi dorë nga njëra prej kërkesave kryesore,

thanë një zyrtar egjiptian dhe një i Hamasit për “AssociatedPress”. Vendimi i Hamasit mund të bëjë që të ketë pushim të luftimeve për herë të parë prej nëntorit të kaluar, si dhe ta hapë rrugën për bisedime të mëtuqeshme për t’i dhënë fund luftës tashmë nëntëmuore.

Izraeli e nisi luftën në Gazë si përgjigje ndaj një sulmi nga Hamasi në jug të Izraelit më 7 tetor, ku u vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe u rrëmbyen rreth 250 të tjerë. Prej atëherë, lufta izraelite në Gazë i ka vrarë më shumë se 38 000 palestinezë, gjysma e të cilëve fëmijë dhe gra, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë. Lufta, gjithashtu, ka shkaktuar dëme të jashtëzakonshme dhe ka nxitur



një krizë të madhe humanitare në Gazë.

Protestuesit i bllokuan rrugët kryesore dhe demonstruan para shtëpive të anëtarëve të Parlamentit të Izraelit.

Në afërsi të kufirit me Gazën, protestuesit izraelitë i lëshuan 1

500 balona verdhezi në nderim të atyre që u vranë dhe rrëmbyen.

Hannah Golan tha se doli për të protestuar kundër “braktisjes së komuniteteve tona nga qeveria jonë”. Ajo shtoi: “Sot janë bërë nëntë muaj nga ajo ditë e zezë dhe ende askush në qeverinë

tonë nuk merr përgjegjësi”.

Izraeli thotë se më shumë se 120 pengje po mbahen ende në Gazë, pasi më shumë se 100 të tjerë u liruan gjatë një armëpushimi të shkurtër në nëntor. Sipas tij, rreth 40 pengje kanë vdekur dhe druhet se më shumë do të vdesin me vazhdimin e luftës.

Bisedimet për armëpushimin kanë ngecur kohë pas kohe për shkak të kërkesës së Hamasit që çdo marrëveshje ta përfshijë përfundimin e luftës.

Kryeministri Netanyahu ka ofruar ndërprerjen e përkohshme të luftimeve, por ka thënë se lufta nuk do të mbarojë derisa Izraeli ta shfarosë Hamasin dhe t’i kthejë të gjitha pengjet që po mbahen nga grupi militant.

# Ish-drejtori i RTK-së thotë se dha dorëheqje për shkak të “presionit politik”

Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, Shkumbin Ahmetxhekaj, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Pas dorëheqjes së tij, Bordi i RTK-së ka emëruar ushtruese detyre të drejtoreshës së përgjithshme, Zana Spahiun. Ahmetxhekaj në “Facebook” ka thënë se vendimi për dorëheqje ka ardhur si rezultat i një presioni politik dhe se nuk është akt dorëzimi i tij. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka ndjekur me shqetësim të thellë zhvillimet e muajve të fundit në RTK, që kanë rezultuar të dielën me largimin e Shkumbin Ahmetxhekajt nga pozita e drejtorit të përgjithshëm

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 7 KORRIK** - Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës, Shkumbin Ahmetxhekaj, ka thënë se ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë meqë, siç ka theksuar, pati “presion politik”. “Ky akt nuk është dorëzim dhe nuk reflekton vullnetin personal për të mos vazhduar me drejtimin e RTK-së, por është kulmim i një presioni politik 7-mujor që rezultoi me mospajtime të thella me Bordin për çështje fundamentale të ecjes tutje të transmetuesit publik”, shkroi ai të dielën në “Facebook”. “Në këtë kontekst, qëndrimi im i mëtutjeshëm në këtë pozitë kur ka mosbesim, mungesë të mbështetjes për procesin e reformës së RTK-së dhe Strategjinë Zhvillimore 2024-2027, është i pakuptimtë dhe do të sillte vetëm bllokadë e stagnim për transmetuesin publik”, shtoi ai. Duke përmendur disa nga punët që janë kryer gjatë kohës sa ai ka qenë në krye të kësaj detyre, Ahmetxhekaj ka thënë se ka shprehur vullnetin që ta ushtronte detyrën deri në finalizimin e procesit të disa punëve, por bordi e

ka injoruar kërkesën e tij. “Në gjykimin tim, një drejtor i përgjithshëm do të duhej të kishte mbështetje të plotë në krijimin e ekipit të tij dhe të mbrohet nga interferimi politik në çfarëdo forme dhe kurdo që mund të shfaqet. Uroj që pasardhësi im të jetë më fatlum në këtë drejtim. Të gjithë kolegëve, faleminderit për besimin dhe durimin e treguar gjatë kësaj kohe! Uroj që RTK-ja të zhvillohet dhe transformohet ashtu siç e pret publiku. ‘Unë kisha një ëndërr’”, ka potencuar ai.

Në anën tjetër, bordi i RTK-së ka njoftuar se kishte mospajtime me Ahmetxhekajin lidhur me rastin e dhunës psikike që ka ushtruar drejtori i radios Arsim Halili ndaj disa grave në RTK, veçanërisht ndaj udhëheqëses së zyrës ligjore. “Bordi ka pritur që drejtori i përgjithshëm ta trajtojë këtë rast konform përgjegjësisë së tij. Bordi rithekson që dhuna psikike dhe çfarëdo lloj presioni i ngjashëm nga kushdo ndaj kujtdo, janë të papranueshme dhe nuk do të lejohen në RTK. Bordi i RTK-së do të vazhdojë të punojë në vazhdimësi për ruajtjen e pavarësisë dhe profesionalizimit të RTK-së”, thuhet në njoftim të bordit. Bordi i RTK-së, në vend të

Ahemxhakaj, e ka emëruar Zana Spahiun në pozitën e ushtrueses së detyrës së drejtoreshës së përgjithshme të RTK-së.

## AGK-ja thellësisht e shqetësuar me presionet politike në RTK

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka ndjekur me shqetësim të thellë zhvillimet e muajve të fundit në RTK, që kanë rezultuar të dielën me largimin e Shkumbin Ahmetxhekajt nga posti i drejtorit të përgjithshëm, ashtu siç edhe ishte paralajmëruar në një letër të organizatave ndërkombëtare të lirisë së medias. “Ahmetxhekaj, një gazetar shumëvjeçar në Transmetuesin Publik, ka treguar për ‘presion politik 7-mujor që rezultoi me mospajtime të thella me Bordin për çështje fundamentale të ecjes tutje të transmetuesit publik’. Bordi i RTK-së, duhet të shpjegojë nëse i nënshtrohet presionit politik në vendimarrjen e vet, dhe nëse detyrimi për largimin e Ahmetxhekajt, ka ardhur si pasojë e kësaj. Bordi aktual, që ka miratuar dorëheqjen e Ahmetxhekajt, më

herët kishte emëruar në postin e drejtorit të Televizionit, Rilind Gërvallën, një ish-aktivist dhe financues i partisë politike në pushtet, Vetëvendosje.

Qeveria e Kosovës, nëpërmjet eksponentëve të saj, duke përfshirë edhe deputetë, disa herë edhe publikisht e ka shfaqur tendencën për kontroll partiak të RTK-së, që është praktikë e papranueshme.

AGK-ja, bën thirrje për adresimin e duhur të ankesave për mënyrën e funksionimit dhe menaxhimit në Radio Kosova 1”, është thënë në reagimin e AGK-së.

AGK-ja ka theksuar se në vend të presionit politik nëpërmjet Bordit dhe përgjysmimit të buxhetit, Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të përkujdesen që të sigurojnë funksionimin e papenguar financiar të Transmetuesit Publik dhe të gjejnë zgjidhje për pronën e saj. “AGK-ja, e çmon rolin crucial që Transmetuesi Publik luan në funksionimin demokratik të vendit, si shtyllë e rëndësishme për lirinë e medias në Kosovë. Gazetarët, kameramanët dhe punëtorët e tjerë të RTK-së duhet të jenë në gjendje të bëjnë punën e

tyre në interes të publikut, pa asnjë lloj presioni politik apo financiar.

Kosova këtë vit ka shënuar rënien më të madhe të viteve të fundit, kur është renditur për 19 vende më poshtë në Indeksin e Lirisë së Medies nga Reporterët Pa Kufij”, është thënë në reagimin e AGK-së. Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka reaguar pas dorëheqjes së drejtorit të Radio Televizionit të Kosovës, Shkumbin Ahmetxhekajt.

“Dua ta theksoj rëndësinë e një transmetuesi publik që gëzon autonomi institucionale dhe pavarësi editoriale”, shkroi ai në platformën X.

Ai i ka shprehur mirënjohje Ahmetxhekajt për “përpjekjet e tij në përmirësimin e menaxhimit financiar të RTK-së”. “BE-ja në Kosovë pret që drejtori i ri i përgjithshëm të emërohet përmes një procesi të bazuar në merita. Ky akt nuk është dorëzim dhe nuk reflekton vullnetin personal për të mos vazhduar me drejtimin e RTK-së, por është kulmim i një presioni politik 7 mujor që rezultoi me mospajtime të thella me Bordin për çështje fundamentale të ecjes tutje të transmetuesit publik”, shkroi ai në “X”.


## Haradinaj e quan “mashtues ordiner” Kurtin: Nëse ka një njeri që e ka larguar Kosovën nga NATO, është pikërisht ai

**PRISHTINË, 7 KORRIK** - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj deklaratës së kryeministrit Kurti i cili ka thënë se asgjë nuk i shërben paqes më shumë se anëtarësimi i Kosovës në BE dhe në NATO. Në llogarinë e vet në

“Facebook”, Haradinaj ka thënë se është Kurti ai i cili e ka larguar Kosovën nga rruga drejt BE-së dhe NATO-s. “Albin Kurti paska thënë se asgjë nuk i shërben paqes më shumë se anëtarësimi i Kosovës në BE dhe në NATO! E paska zbuluar ujin e nxehtë! Por paska harruar mashtuesi se

nëse ka një njeri që e ka larguar Kosovën edhe nga BE edhe nga NATO dhe e ka kthyer në rrugë të mbrapshtë, është pikërisht ai! Ky mashtues nuk po heq dorë nga mashtimet ordinere të tij, edhe pse ai definitivisht nuk mund të mashtrojë njeri më!”, ka shkruar Haradinaj.





# A mund të ndalohet përdorimi i TikTok-ut në Kosovë?

**PRISHINË, 7 KORRIK** - Ndonëse në fund të qershorit Qeveria e Kosovës ndaloi përdorimin dhe funksionimin e aplikacionit TikTok në institucionet shtetërore, një gjë e tillë aktualisht nuk planifikohet në nivel vendi.

Kështu thotë për Radion Evropa e Lirë, zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu. "Analizat dhe vlerësimet e institucioneve dhe ekspertëve në lidhje me gjendjen dhe rreziqet e sigurisë kombëtare kibernetike janë të vazhdueshme. Masat dhe rekomandimet për të ardhmen nxirren vetëm mbi rezultatet e këtyre analizave. Aktualisht, nuk është diskutuar ndalimi i rrjetit social TikTok në nivel vendi", thotë Kryeziu.

Qeveria vendosi të ndalojë TikTok-un në institucionet shtetërore për shkak të rreziqeve kibernetike që, sipas ekzekutivit, ky aplikacion paraqet.

TikTok-u është aplikacion i popullarizuar për shpërndarjen e videove të shkurtra, kompania amë e së cilës, Byte Dance, e ka bazën në Kinë. Në vitin 2021, TikTok-u është shpallur aplikacioni më i shkarkuar në botë, që përdoret nga të gjitha moshat, por të rinjtë janë shënjestra kryesore. Kjo ka rritur shqetësimet për sigurinë e tyre çdo ditë e më shumë.

Shumë vende, përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja, e kanë ndaluar përdorimin e këtij aplikacioni në pajisjet qeveritare, për shkak të dilemave se TikTok-u mund të ndajë të dhënat e përdoruesve me qeverinë kineze.

Në vitin 2023, TikTok-u kishte 1.5 miliard përdorues aktivë në baza mujore, ndërsa deri në fund të vitit 2024 pritet të arrijë në 1.8 miliard përdorues. Numri i kosovarëve që përdorin këtë aplikacion nuk dihet, por videot e publikuara nga përdoruesit kosovarë marrin miliona shikime.

Arbisa Shefkriu, 28-vjeçarja nga Gjilani, e sheh TikTok-un si një platformë të shkëlqyer për ta shprehur kreativitetin dhe për t'u lidhur me njerëz të tjerë nga e mbarë bota. Megjithatë, ajo beson se në Kosovë duhet të ketë nisma për të rritur ndërgjegjësimin dhe sigurinë e përdoruesve të kësaj platforme. "Kjo përfshin edukimin e rinisë për përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të teknologjisë, si dhe monitorimin e përmbajtjes për të parandaluar abuzimin dhe shpërdorimin e platformave të tilla", thotë ajo.

Sipas saj, është e rëndësishme që autoritetet dhe komuniteti të bashkëpunojnë për të gjetur zgjidhje që të sigurojnë një mjedis të sigurt për të gjithë përdoruesit.

## "Edukim për platformat sociale"

Komisionerja për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dermaku, thotë për Radion Evropa e Lirë se Kosova ka vendosur kontakt me TikTok-un dhe janë bërë disa ndryshime për përdorimin e këtij aplikacioni në vend.

Sogojeva-Dermaku shprehet se nga këto takime është vendosur që të përkthen në gjuhën shqipe politikat e privatësisë, dhe të vendoset kufizimi i moshës nga 13 në 16 vjeç për përdoruesit e këtij aplikacioni. Ajo vlerëson se Kosovës i duhet edukim për përdorimin e platformave sociale.

"...të dimë dhe të mësojmë sesi duhet të sillemi në internet, të dimë si ta ruajmë veten dhe të tjerët nga keqpërdorimet në internet, kjo është ajo që duhet të bëjmë", thekson ajo.

## Cilat janë rreziqe nga TikTok-u?

Përdorimi i TikTok-ut mund të paraqesë rreziqe të ndryshme, nisur nga privatësia, e deri te rrezikimi i shëndetit mendor, për shkak të varësisë që mund të

shkaktohet nga përdorimi i aplikacionit, thotë Tanzer Abazi, kryetar i Bordit në Shoqatën Shqiptare Kibernetike. "TikTok-u mbledh një sasi të madhe të dhënash personale nga përdoruesit e tij, duke përfshirë informacione mbi pajisjet, vendndodhjen, kamerën, mikrofonin, audion, pajisjet afër saj dhe sjelljen e përdoruesve. Këto të dhëna mund të përdoren për qëllime komerciale apo të ndahen me palë të treta", thotë Abazi.

Sipas tij, shqetësues është edhe fakti që TikTok-u ka bazën dhe serverët qendrorë në Kinë, që sipas tij, është një shtet jo shumë miqësor me Kosovën.

Kina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, të shpallur më 2008. "Ekzistojnë shqetësime se të dhënat e mbledhura nga TikTok-u mund të përdoren nga qeveritë apo aktorë të tjerë për qëllime të padëshiruara, përfshirë mbikëqyrjen apo ndërhyrjet në privatësinë e përdoruesve", thotë Abazi.

## Kush e ka ndaluar plotësisht e kush e kufizoi përdorimin e TikTok-ut?

Përderisa shumë nga vendet e

Bashkimit Evropian e edhe institucionet e bllokut evropian, kanë ndaluar përdorimin e TikTok-ut në pajisje shtetërore dhe brenda institucioneve shtetërore, ka vende që kanë ndaluar plotësisht përdorimin e këtij aplikacioni.

India, Afganistani, Irani, Nepali, Pakistani janë disa nga vendet në të cilat TikTok-u është i ndaluar plotësisht.

Arsyet e ndalimit lidhen kryesisht me sigurinë kibernetike dhe përmbajtjen që ofron ky aplikacion. Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kërcënuar me ndalimin e përdorimit të këtij aplikacioni.

I shtyrë nga shqetësimet e mëdha në mesin e ligjvënësve amerikanë se Kina mund të ketë qasje në të dhënat e amerikanëve, apo t'i vëzhgojë ata përmes këtij aplikacioni, Senati amerikan e ka kaluar në prill një projektligj i cili do ta ndalojë TikTok-un në Shtetet e Bashkuara, nëse pronari i saj - firma kineze Byte Dance - nuk e shet atë brenda një viti.

Kompania kineze Byte Dance, e cila e ka në pronësi TikTok-un, ka thënë se nuk e ka ndër mend ta shesë aplikacionin e famshëm.

# 'Obligimet për Kosovën dhe Serbinë nga dialogu s'ndryshojnë me lehtësuesit e rinj'

PRISHTINË, 7 KORRIK - Vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) janë pajtuar për t'ia zgjatur mandatin të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, deri në janar të vitit 2025. Ky vendim, për të cilin më herët kishte paralajmëruar përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, tashmë ka marrë pëlqimin e vendeve anëtare.

Pajtimi u arrit disa muaj pasi Borrelli e kishte emëruar Lajçakun si ambasador të BE-së në Zvicër, ku ishte dashur të niste punën më 1 shtator, menjëherë pasi t'i skadonte mandati në rolin e lehtësuesit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Me vazhdimin edhe për pesë muaj të Lajçakut në rolin e lehtësuesit të dialogut, BE-ja dëshiron të sigurojë që në këtë çështje të mos ketë vakum derisa pritet të emërohet pasardhësi i tij.

Emërimi i pasardhësit të Lajçakut është lidhur tani në mënyrë direkte me procedurën për emërimin e udhëheqësve të rinj në institucionet e BE-së për mandatin e ardhshëm pesëvjeçar.

Në kuadër të paketës, për të cilën para dhjetë ditësh u pajtuan liderët e vendeve anëtare të BE-së në takimin e Këshillit Evropian, është edhe

nominimi i kryeministres së Estonisë, Kaja Kallas, në postin e përfaqësueses së lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë.

Por, për të nisur mandatin ajo duhet të presë që, së pari Parlamenti Evropian të konfirmojë zgjedhjen e Ursula von der Leyen si kryetare e Komisionit Evropian për një mandat tjetër prej pesë vjetësh. Pastaj ajo do të propozojë nga një anëtar të Komisionit të saj nga secili vend anëtar, dhe secili prej tyre duhet të kalojë procesin e dëgjimit në Komisionet e Parlamentit Evropian dhe të marrin konfirmimin.

Pasi Kallas do të ketë një rol të dyfishtë, atë të përfaqësueses së lartë për politikë të jashtme dhe siguri, por edhe të zëvendës-presidentes së Komisionit Evropian, edhe ajo duhet të kalojë përmes procedurës së konfirmimit në Parlamentin Evropian.

Në rastin më të mirë, nëse Ursulavonder Leyen më 18 korrik në seancën plenare të Parlamentit Evropian siguron shumicën e votave të deputetëve, dhe pastaj në vjeshtë konfirmohen të gjithë komisionarët, afati më i afërt kur Kaja Kallas do të marrë përsipër nga Josep Borrell udhëheqjen e diplomacisë së përbashkët të BE-së është 1 nëntori i këtij viti. "Në rastin më

të mirë, Kallas do të mund të nisë punën si pasardhëse e Borrellit më 1 nëntor. Pastaj do t'i duhet së paku disa javë që të vendosë se kë dëshiron ta emërojë si të dërguar të posaçëm për dialog mes Kosovës dhe Serbisë. Prandaj, BE-ja e ka parë të rrugës që t'i zgjasë edhe për pesë muaj mandatin Lajçakut me shpresë se deri atëherë do të emërohet pasardhësi i tij", i ka thënë Evropës së Lirë një diplomat evropian.

Për shkak të rrethanave në dialog, i cili nuk po prodhon rezultate në formën e pajtimit të palëve, diplomatët në Bruksel nuk presin që në muajt në vijim të ketë ndonjë kthesë në këtë proces. Lajçak dhe Borrell patën një përpjekje në fund të qershorit për të organizuar një takim të nivelit të lartë në kuadër të dialogut ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Por, ato përpjekje dështuan.

Edhe pse Kurti dhe Vuçiq shkuan në Bruksel duke iu përgjigjur ftesës së BE-së, takim të përbashkët mes tyre nuk pati. Takimi i fundit në nivelin e lartë në kuadër të dialogut ishte zhvilluar më 14 shtator të vitit 2023.

Mungesën e takimeve në këtë nivel diplomatët e shohin si dëshmi se procesi nuk po shkon me dinamikën e dëshiruar.

Kaja Kallas, pasardhësjë e Josep Borrellit, kur të marrë këtë post do të jetë edhe lehtësuese e dialogut në nivelin e lartë. Pra, ajo pritet t'i ftojë në takim liderët nga Kosova dhe Serbia kur takimet janë në nivelin e lartë dhe t'i udhëheqë ato takime.

Ndërkaq, takimet në nivel të kryengociatorëve do t'i lehtësojë në emër të BE-së i dërguari i posaçëm për dialogun. Në këtë formë, në BE nuk presin të ketë ndryshime. Por, se si do t'i qaset dialogut në të ardhmen, do të vendosë pasardhësjë e Borrellit, që pritet të jetë Kallas nëse nuk do të ketë ndonjë pengesë në emërimin e saj. Dhe, nuk do të kishte kuptim që Borrell në fund të mandatit të tij të emërojë dikë që do të punojë pastaj me pasardhësen e tij. Kjo është edhe arsyeja pse i është vazhduar mandati Lajçakut për t'ia lënë në duar përfaqësueses së lartë, Kallas, që ajo ta emërojë edhe të dërguarin për dialog. "Qasja mund të ndryshojë. Por, nuk presim ndryshime të mëdha. Pasi dialogu nuk po shkon sipas pritjeve që kanë ekzistuar në BE, por ato që nuk do të ndryshojnë janë obligimet e Kosovës dhe Serbisë që kanë dalë deri më tash nga procesi i dialogut", ka thënë një diplomat i BE-së.

Diplomatët në BE thonë se,

kushdo që të lehtësojë dialogun në emër të Bashkimit Evropian, duhet të ndjekë mandatin dhe detyrat që i caktojnë vendet anëtare. E vendet anëtare janë të njëzëshme se Kosova dhe Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha obligimet që kanë dalë nga marrëveshjet e arritura deri më tash në procesin e dialogut. Kjo, sipas këtyre burimeve, përfshin edhe zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe aneksin për implementimin e kësaj marrëveshjeje, për të cilën palët ishin pajtuar në pranverën e vitit 2023 në Ohër.

Kaja Kallas, kur të marrë detyrën, do të jetë përfaqësuesja e katërt me radhë e lartë e BE-së që do ta lehtësojë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Dialogu kishte nisur në mandatin e Catherine Ashtonit, e cila ishte edhe përfaqësuesja e parë e lartë e BE-së prej kur ky post ishte krijuar me Traktatin e Lisbonës. Pastaj rolin e lehtësueses në nivel të lartë e kishte Federica Mogherini dhe pas saj Josep Borrell. Normalizimi i raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdon të shihet si një prej prioritetëve kryesorë të BE-së në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, si dhe një prej sfidave kryesore për sigurimin e stabilitetit afatgjatë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.



## Xhemajl Rexhari zgjidhet kryetar i Bordit të AGK-së

Prishtinë, 7 korrik - Xhemajl Rexhari është zgjedhur kryetar i Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës. Me Statutin e ri të AGK-së, parashihet edhe pozita e

nënkryetarit/es, në të cilën është zgjedhur Naile Dema Selmani (Radio Dukagjini). Anëtarët e tjerë të Bordit janë zgjedhur: Milot Hasimja (Klan Kosova), Florande Morina (T7),

Blerta Dalloshi (TV Klan), Mehmet Krasniqi (TV Dukagjini), Fatlum Jashari (ATV), Jehona Hulaj (Telegrafi) dhe Besnik Velija (Gazeta Express).



## Kërkohet shtatore për ish-të burgosurit politikë



PRISHTINË, 7 KORRIK - Për shumë vjet shumë të burgosur politikë shqiptarë vuajtën në burgjet jugosllave. Por, pavarësisht kësaj, në Kosovë nuk ka ndonjë shenjë në kujtim të atyre që e bënë hapin e parë për lirinë e vendit.

Selatin Novosella, në moshën 18-vjeçare, për plot 30 ditë u mbajt i burgosur në qeli në burgun famëkeq të Prishtinës, për shkak se në qershorin e vitit 1964 Novosella, si anëtar i Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, shkroi disa parulla.

Në to kërkohet liri për shqiptarët, kundër shtypjeve mizore që po e përjetonin nën Jugosllavi. "Këtu ku jemi, ka qenë 2.5 metra me 3. Kemi qenë 4 veta. Shtretër nuk kemi pasur, as dyshekë, as mbuloja. Kemi fjetur në tokë. Tash i kanë punuar disa tualete, por për ta kryer nevojën është dashur në një qyp", tha Novosella, ish-i burgosur politik.

Pas kësaj, Novosella do të burgosej edhe disa herë, përfshirë atë të vitit 1968, si organizator i demonstratave masive në disa

qytetet të Kosovës. E fat të njëjtë me të patën edhe shumë shqiptarë të tjerë.

Por, sa është numri i të burgosurve politikë shqiptarë, që në burgjet serbe përjetuan torturat me çnjerëzore? "Unë e kam një shifer, që është diku 14 mijë e 100, ndonëse edhe për këtë shifer thonë se është e vogël, është akoma më shumë. Ne kemi vuajtur shumë. Unë mendoj që për opinionin është mirë të dihet që të burgosurit politikë shqiptarë, në Kosovë dhe viset e

tjera në ish-Jugosllavi, kanë vuajtur mbi 600 shekuj burg, 60 mijë vjet, 21 milionë e 900 ditë burg, i kanë mbajtur të rinjtë e të rejtat e popullit shqiptar", tha Ismet Sylejmani, kryetar nderi i Klubit Politik "Afrim Zhitia".

Sylejmani thotë se vuajtjet e kësaj kategorie nuk duhet të harrohen. Për këtë ka një propozim. "Unë kam propozuar që shtatorja të vendoset në sheshin 'Fontana' afër Qendrës Studentore. Dhe e kam menduar që të jetë një i burgosur politik i lidhur në pranga

edhe në duar edhe në këmbë. Me shtat gjigant, i lodhur, i torturuar, por i pathyeshëm shpirtërisht", tha ai.

E me idenë e Sylejmanit po pajtohen edhe në Shoqatën e të Burgosurve Politikë. Por, këta thonë se vendi më i përshtatshëm do të ishte para objektit të Ministrisë së Kulturës në Prishtinë. Ndryshe Qendra e Paraburgimit në Prishtinë, vendi ku shumë të burgosur politikë shqiptarë janë torturuar mizorisht, së fundmi është shndërruar në muze. (teve1)

## Ish-inspektori i AKI-së: Mungesa e sigurisë publike po kërcënon jetën e qytetarëve



PRISHTINË, 7 KORRIK - Ish-inspektori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Burim Ramadani, ka thënë se është shqetësuese mungesa e sigurisë publike. Ramadani në "Facebook" ka shkruar se siguria publike është më e keqe sot dhe se kohën e fundit është rritur dukshëm ndjenja e pasigurisë të

qytetarët. "Shqetësuese mungesa e sigurisë publike. Qytetarët e Kosovës po përballen me dobësim të dukshëm të sigurisë publike. Qytetari është më i pambrojtur sot! Siguria publike është më e keqe sot! Lajmet nga anekënd Kosovës janë të mbushura me raste dhune, sikurse ishin edhe lajmet

e mëngjesit sot. Krimi që ka arritur shkallë të lartë në kohët e fundit patjetër se rrit dukshëm ndjenjën e pasigurisë së qytetarëve", ka shkruar Ramadani. Ai ka shtuar se siguria publike është kusht i domosdoshëm për jetën më të mirë dhe më të sigurt të qytetarëve.

## Paraqitet raporti gjashtëmujor i strategjisë 'policia e drejtuar nga inteligjenca dhe policimi në bashkësi'

PRISHTINË, 7 KORRIK - Në një takim të mbështetur nga OSBE-ja, në të cilin morën pjesë drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha dhe eprorë të lartë të PK-së, përfaqësues të organizatave si IPK-ja dhe

UNDP-ja, u mbajt takimi ku u raportua rreth realizimit të planit gjashtëmujor të veprimit të Strategjisë 'Policia e drejtuar nga inteligjenca dhe policimi në bashkësi'.

Në takim, nga përfaqësuesi i Divizionit të Policimit në

Bashkësi, u raportua për secilën nga objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit, duke shpalosur shkallën e realizimit, sfidat dhe rezultatet e arritura për përmbushje të aktiviteteve të kësaj strategjie.



## Ministri i Bujqësisë u dërgon mesazh kritikuesve: Kur s'ka hajni, Zoti dërgon begati!

PRISHTINË, 7 KORRIK - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka njoftuar se, sipas analizave për konsum, një qytetar në Kosovë konsumon në ditë mesatarisht prej 250 deri 300 gramë miell. "Për 365 ditë kjo i bie 140 deri 150 kg grurë. 150 kg x 1.75 milion banorë = 262 mijë tonë grurë. 67 kilogramë

grurë në vit është mesatarja botërore për kokë banori. Kosova ka importuar vitin e kaluar 139 000 ton me grurë. E këtë vit, toka e bekuar e Kosovës, minimalisht po i prodhon 140 000 deri 150 000 ton më shumë se vitin e kaluar!", ka shkruar Peci në "Facebook". Ai ka thënë se kanë të dhëna të sakta për çdo

hektar të mbjellë. "Në këtë llogaritje nuk përfshihen sipërfaqet nën lha që ne si ministri nuk i subvencionojmë. Sukseseve të Kosovës duhet t'iu gëzohemi që të gjithë. Xhelozia e smira dëmtojnë rëndë shëndetin! Do punue koka, me prodhues toka! Kur s'ka hajni, Zoti dërgon begati!", ka shkruar Peci.



## Ligji i ri për procedurat e ATK-së, Gërxhaliu: Diskriminues për ekzistencën e NVM-ve në Kosovë



PRISHTINË, 7 KORRIK - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka theksuar se mungesa e një dialogu të mirëfilltë publiko-privat gjeneron barriera për sektorin privat dhe forcon burokracinë institucionale në dëm të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Ai ka thënë se ligji i ri për procedurat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) po krijon sfida të reja dhe të mëdha për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në vendin tonë. "Një ndër ndryshimet më të diskutueshme është obligimi për kryerjen e transaksioneve përmes bankës për shumën mbi 300 euro. Kjo rregullore po krijon një barrë të rëndë financiare për

kompanitë e vogla dhe të mesme, të cilat shpeshherë varen nga pagesat në dorë për t'i mbajtur aktivitetet e tyre të përditshme", ka thënë ai. Gërxhaliu ka treguar për problemet këtij ligji. "Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shumë NVM kanë hasur në vështirësi për t'i mbledhur pagesat e shitjeve në kohë. Në të kaluarën pagesat bëheshin në dorë në kohën reale të furnizimit të produkteve, ndërsa tani çdo transaksion mbi 300 euro duhet të kryhet përmes bankës. Ky ndryshim ka çuar në vonesa të shumta në ekzekutimin e pagesave nga klientët, duke zhytur shumë kompani në borxhe dhe duke krijuar një cikël negativ financiar", ka theksuar ai.

Ai, gjithashtu, thotë se ligji i ri përmban zgjatjen e afatit të vlerësimit tatimor retroaktiv nga 6 në 10 vjet dhe zgjatjen e afatit të ruajtjes së librave nga 6 në 10 vite. "Këto ndryshime përfaqësojnë një barrë të shtuar për bizneset, sidomos për NVM-të, të cilat tashmë përballen me 101 barriera në ushtrimin e veprimtarive të tyre. Kjo rritje e burokracisë dhe përgjegjësisë administrative vetëm sa e komplikon më tej funksionimin e tyre", është shprehur Gërxhaliu. Duke folur për efektet negative të shkaktuara në mjedisin biznesor, ish-kryetari i OEK-ut ka thënë se në një situatë ku sektori privat në Kosovë tashmë përballlet me sfida të mëdha, këto ndryshime të ligjit janë si një goditje e dyfishtë. "Nuk

është çudi që shumë NVM po mendojnë të mbyllen ose të zhvendosen jashtë Kosovës, duke e bërë kështu mjedisin biznesor në vendin tonë edhe më të pafavorshëm për investitorët e huaj. Siç duket, në vend se ta përmirësojmë mjedisin biznesor, po e bëjmë më të vështirë dhe të paqëndrueshëm", ka deklaruar eksperti i ekonomisë. Gërxhaliu ka shtuar se një nga arsyet kryesore për këto ndryshime të papërbalueshme është mungesa e diskutimeve me sektorin privat gjatë hartimit të këtyre ligjeve. "Këto vendime janë marrë nga kolltukët dhe zyrat e institucioneve, pa u dëgjuar zëri i atyre që preken direkt nga këto ndryshime - bizneset private", ka thënë ai.

Sipas Gërxhaliut, sektori privat në Kosovë është boshti kurrizor i shtetësisë së vendit tonë. "Ata janë heronjtë e pasluftës, të cilët me shumë sakrificë kanë ndihmuar në ndërtimin e një ekonomie funksionale dhe të qëndrueshme. Nëse dëshirojmë një të ardhme më të mirë për Kosovën, duhet të krijojmë ligje që i mbështesin dhe i ndihmojnë këto biznese të zhvillohen dhe të përparojnë, jo t'i ngarkojmë me barriera të panevojshme dhe burokraci të tepruar. Tentativa për rritjen e burokracisë dhe qasja për barazi në varfëri duke dëmtuar sektorin privat e në veçanti atë prodhues është rreziku që po forcohet e në heshtje po zbatohet", ka theksuar Gërxhaliu.

## Unioni i Bizneseve Shqiptare-Gjermane themelon Degën në Kosovë, Shkëlzen Jusaj zgjidhet kryetar




PRISHTINË, 7 KORRIK - Unioni i Bizneseve Shqiptare-Gjermane (UBShGj) ka mbajtur Kuvendin e Parë Themelues të Degës në Kosovë. Biznesmeni Shkëlzen Jusaj me 19 vota ka marrë besimin si kryetar i Degës së UBShGj-së në Kosovë, ndërsa anëtarë të kryesisë janë zgjedhur edhe Burim Kuraja, Faton Kutllovci, Miftar Veseli dhe Faton Nuredini.

Shkëlzen Jusaj, pas përzgjedhjes, ka thënë se Kosova aktualisht po vuan për fuqi punëtore dhe ka propozuar që të hapen shkolla profesionale. "Kosova po vuan për fuqi punëtore. Ne u propozojmë institucioneve të krijojnë shkolla profesionale për ta fuqizuar fuqinë punëtore. Unë kam propozime që të kemi memorandume bashkëpunimi, të harmonizojmë

dhe t'i vendosim në drafte t'i dërgojmë në institucione për t'i zhvilluar. Ju falënderoj të gjithëve për besimin dhe sigurisht se do ta bëjmë maksimumin të mos u dështojmë", ka thënë Jusaj. Drejtori ekzekutiv i UBShGj-së, Bekim Brestovci, ka thënë se qëllimi i Unionit është që pas 10 viteve punë të suksesshme në Gjermani e diasporë, të shtrihet dhe rrisë anëtarësinë edhe në Kosovë.

# Një roman shqiptar i nivelit botëror



Çdo vend ka së paku dy fytyra, një legjendare dhe një reale. Shqipëria ka atë fytyrë që ia japin sytë që e shikojnë, por kjo fytyrë është gjithmonë bashkim i të vërtetës me legjendën. Ajo gjithmonë jep pak më shumë, ose shumë më tepër se ç'kërkojmë. Bëhuni pushtues dhe do të gjeni luftë pa mirënjohje. Bëhuni të sjellshëm dhe do të keni miqësinë e pakursyer të botës. Bëhuni pak mosbesues dhe do t'ju dalë një roje prapa çdo guri, një polic pas çdo dere, një mister në çdo rrugë. Bëhuni të besueshëm dhe do të keni muzikë në kafenetë e Tiranës, do të ëndërroni ngjyrat e qilimit të Korçës, do të ndieni erën e rakisë së vjelë në Përmet. Përkthuesi përbuzjen, përfilljen, mëshirën, dhe do të mendoni që do të ndikoni në sytë e një shkrepi të thepisur, me faqe të zhbiruara që duket sikur është duke thithur duhan mendueshëm dhe duke ju gjykur, duke ju zhveshur dhe përlur ashtu siç e ka përlur Ismail Kadare gjeneralin e ngarkuar me një mision. Kështu ndodh që nga kohët e neolitit, malësori rri mbështetur mbi një shkëmb, gati për të qëlluar me pushkë, shtizë, gur, çdo gjë që vjen nga deti ose nga marshimet e ushtrive. Secili ngrë një shkëmb dhe toka e thatë nën ta i krekoset eshtrave të ushtrive sulmuese që kanë dhunuar, skllavëruar, torturuar, masakruar, therur popullin pa mundur ta pushtojnë, ose ta shkatërrojnë asnjëherë. Ata janë njerëz që kanë një gjuhë më të vjetër se ajo e heronjve homerikë, e prekur, e ndikuar nga gjuhët e të gjithë pushtuesve të saj, por e paprekur në strukturën e saj. Në shqipe mund të numërosh nga dy deri në pesë në latinishten e vonë, më tej në gjuhën turke dhe pastaj në sllavishte, por njëshi thuhet gjithmonë njëjtë, ashtu siç thuhet para tre mijë vjetësh.

Dhe kjo është e mjaftueshme: një i përfaqëson të gjithë shqiptarët në Shqipëri. Në romanin e Ismail Kadaresë malësori Nik Martini shtie kundër çdo ushtari italian të vendosur në plazh, ai është një si njëqind. Punëtori i vjetër Reiz, i vrarë (i helmuar) nga kokcat e një armiku të vdekur para njëzet vjetësh, është vetëm dhimbja e madhe dhe zemërimi i madh i një populli me histori tragjike. Midis këtyre dy të vdekurve të vetmuar, gjenerali i cili mbledh divizionet dhe ushtritë e skeleteve, ndihet më i mundur se paraardhësit e tij të luftës. Ai vallëzon një kadril të çuditshëm mes varresh me gjeneralin dorac të një ushtrie tjetër të vdekur dhe me një prift të dyshimtë. Nga ky vend mesdhetar ai sheh për dy vjet zhvarrimet kuturu në lloçin e vjeshtës dhe në skllotën e dimrit. Nga kronologjia rigorozë dhe dramatike e rëfimit të tij, Kadare ia ka mohuar pranverën gjeneralit. Gjithçka fillon me shi dhe borë, gjithçka mbaron me erë. Megjithatë, buzëqeshja dhe pranvera janë ende atje, në malet e larta. Buzëqeshja gjakftohtë e humorit që e bën armikun e vjetër një kafshë kureshtare, por nuk e trulllos, është edhe e gatshme për t'u bërë e përzemërt me kusht që tjetri të bëjë lëvizjen e parë, buzëqeshje shumë njerëzore, guximtare dhe besnike, e kujtesës së gjatë dhe e durimit të shkurtër. Shqipëria gjithashtu ka një pranverë e cila mund të përkthehet në gjuhën e komunizmit modest të saj në fund si ndjenjë gëzimi e jetesës, jo për të jetuar më mirë, por për të jetuar gjithçka, që është shumë më mirë se të mos kesh asgjë. Vise të taksave dhe shkollave të lira, vend i shtresës feudale dhe i harruar nga ana e Evropës, Shqipëria gjithmonë ka pasur dhe ende ruan një traditë të fortë me poezinë orale. Për përvjetorin e njëzet e pestë të çlirimit të saj,

Ismail Kadare i jep lexuesit francez një roman të nivelit botëror, çka do të thotë shumë, por, për më shumë, ai roman është zëri i mijëvjeçarit që u flet burrave të Shqipërisë për shekullin e ringjalljes së saj.

28 nëntor 1969

Përktheu nga frëngjishtja: Ag Apolloni. Shënim: Titulli i artikullit është nxjerrë nga brendia e tekstit, i cili është vendosur si parathënie e botimit frëngjisht të romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", të cilin Escarpit e cilëson "roman de stature mondiale" (Albin Michel, Paris, 1970, f. 9-11). Robert Escarpit (1918 – 2000), profesor universitar, gazetar, kritik letrar dhe shkrimtar i njohur francez. Intelektual majtist, njohës i kulturës dhe politikës shqiptare, autoritet në botën akademike, kulturore dhe politike frënge, ka shkruar disa libra dhe është bërë objekt i disa studimeve. Ndër veprat e tij veçohen: Sociologjia e letërsisë (1958), Revolucioni i librit (1969), Letraria dhe socialja: elemente për një sociologji të letërsisë (1970), Shkrimi dhe komunikimi (1973) etj.

## Artan Fuga: Leksioni që Kadare u dha urrejtësve të tij



Profesori Artan Fuga në një reagim në Facebook, ka shkruar për të ndjerin Ismail Kadare. Fuga shkruan se ajo që klasa politike dhe elitat nuk kuptuan dot për të, është pse 30 vjet rresht, Ismail Kadare heshti dhe nuk denjoi të bënte dikë personazh madhor të veprës së tij.

### Misteret e historise shqiptare!

Ajo që klasa politike dhe elitat nuk kuptuan dot, që nuk e menduan dot, që nuk paten fuqi ta shpjegojnë, ta flasin, ta thone, është: Pse 30 vjet rresht, deri sa iku nga kjo bote e degraduar, Ismail Kadare, ky shkrimtari dhe mendimtar i nivelit nga me te lartet që ka nxjerre historia shqiptare, heshti, nuk foli, nuk dha jo me nje veper madhore per epoken tone, por as denjoi te bente dike personazh madhor te vepres se tij, apo te shprehej thelle, gjere per kete periudhe te rende qe shoqeria shqiptare kalon ne Shqiperi dhe Ballkan.

Heshti! Kuptohet se perse nuk ja hodhi gurin, por u vetepërmbajt, por shpjegoni se perse mjeshteri i fjales nuk pranoi ta konsideronte pozitivisht. Lereni disidencen e tij ne epoken totalitare! Ai beri me shume se c'do shqiptar! Por, gjykoni pak heshtjen e tij tridhjetvjecare, cfare disidence ne kohe lirie! Cfare perbuzje madhore! Cfare domethenieje madhore heshtja e tij, deri sa arriti ne refuzim per te folur edhe ne mikromjedis. Bravo mjeshter! Nuk e meritoni! Si nje gjirokastrit i madh, mospelqimin e shpreh me heshtje, neglizhim, me hecqe nga fushepamja e tij ate qe neverit. Nuk te sheh me! Je mosgje per te! Mos kujtoni se ishte i semure! Fotot dhe videot ku ai heshti, hesht, hesht jane madheshitore! C'nuk bene t'i shkepusunin nje levdate. Nuk blene dot vecse heshtjen e tij! Heshtje qe ne kodin tone gjirokastrit eshte perbuzje! Ketu qendroni! Mos merremi me varreza e pune varremiheshish!





# Basti i Macron, që mund t'i sjellë fundin politik



“Do të bëj gjithçka që të mos ketë më arsye për të votuar ekstremet”, premtonte Emmanuel Macron teksa festonte zgjedhjet e tij të para në Elysee. Presidenti më i ri i Republikës së Pestë donte të dilte mbi të majtën dhe të djathtën, en même temps. Një super-qendër që supozohet të thyente bipolarizmin. Dhe të ndalonte kërcënimin e populistëve që tashmë po përhapej në të gjithë kontinentin. Shtatë vjet më vonë, Evropa po pret me frymë të ndalur për të parë nëse partia e Marine Le Pen do të ketë një shumicë absolute dhe pretenduar qeverisjen. “Njeriu që mburrej se kishte eliminuar ekstremistët, në fakt i favorizoi ata, duke dobësuar të djathtën dhe të majtën. Ky ishte gabimi i tij”, vëren filozofi Pascal Bruckner, i cili edhe pse ka votuar dy herë për Macronin, nuk e ka kuptuar bastin e hedhur nga kreu i shtetit një muaj më parë. Bruckner e sheh si një gjest të ngjashëm me atë të David Cameron me referendumin për Brexit të cilin ai ishte i bindur se do ta fitonte. “Macron mendoi se mund të vendoste francezët

në një zgjedhje të detyruar, por është ai që e gjen veten në këtë situatë. Atë 7 maj të vitit 2017, udhëheqësi kishte ecur i vetëm deri në skenën e ngritur para Piramidës së Luvrit. Dhe këtë mbrëmje ai do të gjendet sërish i vetëm përballë rezultateve të zgjedhjeve që caktoi, duke u konsultuar me një grusht bashkëpunëtorësh, pa e informuar as kreun e qeverisë, Gabriel Attal, i cili filloi një fushatë të çmendur për të parandaluar që e djathta ekstreme të vijë në pushtet. “Macron – vazhdon Bruckner – besonte se ishte i gjithëfuqishëm, se ai qeveriste kohën dhe diktonte axhendën. Ai mendonte se inteligjenca e tij do të joshte masat. Në realitet, ai ishte një burim acarimi”. Kreu i shtetit luajti poker me demokracinë, vijon filozofi. “Shkoi keq për të, por ndoshta dëmi mund të kufizohet nëse Le Pen pengohet të marrë një shumicë absolute. Sigurisht që Franca do të bëhet e paqeverisshme dhe do ta fusim Evropën në telashe. Liderët e tjerë e shikojnë Macronin sikur të ishte i çmendur”.

Edhe shtatë vite më parë, pakkush besonte në llogaritë e ministrit të atëhershëm të Ekonomisë që arriti të bënte “grushtin e shtetit të shekullit”. Ishte imazhi që ai përdori, duke e krahasuar ngritjen e tij në pushtet me një plan të mirëmenduar. Një ish-bankier investimesh, i rritur në shkollat e elitës dhe më pas në prapaskenat e pushtetit, pa u përballur më parë me një fushatë elektorale, kishte pushtuar Elysee-ë, që sot duket si një kështjellë e rrethuar. Dje u përhap lajmi se zona e kuqe rreth pallatit presidencial është zgjeruar për arsye sigurie. Shumë kriza më vonë – nga jelekëverdhët, te pandemia – Presidenti ndoshta shpresonte të rizbulonte atë frymë që e solli në pushtet. Fjala “guxim” përmendet shpesh ndër besnikët e tij të fundit për të përcaktuar se çfarë mbetet nga makronizmi. “Ne jemi bërë borgjezë, por nuk jemi të tillë. Ne dolëm nga hiçi, filluam nga e para”, deklaroi kreu i shtetit disa javë më parë, duke u folur trupave të tij dyshues dhe të frikësuar. “Ka një dimension çmendurie tek Presidenti, i pëlqen të

shkelë kufijtë. Shkelja e tij e parë ishte Brigitte”, kujton Bruckner duke aluduar për marrëdhënien e studentit të ri me mësuesen e tij në shkollën e mesme katolike në Amiens. Gruaja e tij mbetet pika e vetme e stabilitetit në një kontekst që ndryshon me shpejtësi. Në vitin 2017, Macron kishte marrë 350 deputetë në Assemblée Nationale, më pas 250 në 2022. Sonte ai mund të humbasë edhe njëqind të tjerë, sipas parashikimeve të fundit që i japin Rassemblement National si blloku i parë, midis 200 dhe 230 deputetë. Bruckner e quan partinë e Marine Le Pen “Resentiment National”. Një mllef kombëtar që vjen nga larg dhe i ka dhënë Macronit etiketën e Presidentit të të pasurve. “Ne jemi në thelb një popull i njerëzve ziliqarë. Amerikanët kanë një tabu: seksin. Për ne francezët është paraja”, shpjegon filozofi. “Pejga e djallit”, për të parafrazuar Papa Françeskun. “Në Francë çdo person i suksesshëm shihet me dyshim dhe zili”. Nga ana tjetër, Bruckner ishte joshur nga ajo qasje liberale aq pak e përhapur në Francë. “Këtu është padyshim një recetë që

nuk funksionon nëse nuk shoqërohet me një dozë autoritarizmi dhe ndonjë gjest rishpërndarjeje pasurie, siç është ai patrimonial që Macron gabimisht e ndërpreu”. Kreu i shtetit nuk ishte në gjendje t'i fliste barkut të vendit. “Ai nuk i njeh francezët,” thotë Bruckner. “Ai është shumë i zgjuar, gjithmonë i bukur, gjithmonë i ri. Të paktën Hollande po shtonte peshë, djersitej, pengohej. Ishte më e lehtë për t'u identifikuar me të”. Në disa drejtime, kundërpesh është vetë Le Pen. “Pas dyzet vjetësh jetë politike – vëren filozofi – ende nuk ka mësuar të flasë mirë frëngjisht. Babai i saj ishte një orator i madh”. Fjala, vazhdon filozofi, nuk është më në modë. “Macron është bërë si Assourancetourix, ai personazhi i Asterix që askush nuk dëshiron ta dëgjojë më dhe sapo hap gojën të gjithë bërtasin: hesht. Rruga e arsyes është vënë përfund”. Dhe Macron quhej Méprisant de la République. “Jam dakord, duket përcmuese”, përfundon Bruckner. “Por në këtë ai është gjithashtu shumë francez”.

/ La Repubblica. Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Ballkani i motivuar për ndeshjen e parë në Ligën e Kampionëve

**SUHAREKË, 7 KORRIK** - Kampioni i Kosovës në futboll Ballkani, është nisur drejt Andorrës ku të martën do ta zhvillojë ndeshjen e parë kualifikuese në Ligën e

Kampionëve, kundër skuadrës së këtij vendi Santa Coloman. Ndeshja pritet të fillojë nga ora 20:00. "Të dashur tifozë dhe gjithë ju dashamirë të FC Ballkanit.

Ndeshja me Santa Coloman është afruar dhe ne jemi gati për të udhëtuar në Andorrë, atje ku të martën zhvillojmë duelin e parë. Të motivuar si gjithmonë,

shkojmë për ta filluar kampanjën në Ligën e Kampionëve dhe për të kërkuar sukseset e radhës! Na priftë e mbara", thuhet në njoftimin e Ballkanit.



## Khaka: Nuk e meritoni të humbni kështu

**CYRIH, 7 KORRIK** - Kapitani i Zvicrës, Granit Xhaka pas humbjes ndaj Anglisë në çerekfinalen e Euro 2024-shit, është shprehur se është trishtim dhe zhgënjim kjo humbje, pasi sipas tij nuk e kanë merituar këtë. Tutje, Xhaka tha se përkundër rezultatit final, ata janë krenarë se ku kanë arritur. "Ndjenja fillestare është trishtim dhe zhgënjim, sepse nuk e meritoni të humbni kështu. Nga ana tjetër, ne mund të jemi krenarë për veten tonë. Nga ndeshja e parë e deri më sot, ne vazhduam të përmirësoheshim dhe treguam karakter të madh, shpirt të madh ekipor dhe gjithmonë i thoshim vetes "të na mundin, do të duhet shumë", ka thënë Xhaka. Mesfushori shqiptar ka deklaruar se mbështetja e tifozëve ishte e madhe, dhe thekson se ua kthyen këtë mbështetje më shumë se sa

pritej. "E pamë mbështetjen në stadium, e pamë mbështetjen në rrjetet sociale dhe në Zvicër. Për ne ishte shumë e rëndësishme t'u kthenim diçka. Unë mendoj se ne u kthyem atyre shumë më tepër sesa pritej", ka shtuar Xhaka.

### Saka: Lojtar dhe njeri i mrekullueshëm

Granit Xhaka dhe Zvicra e tij mbyllën aventurën në "Euro 2024" në fazën e çerekfinaleve pasi nuk mundën të shkonin përtej pas përplasjes me Anglinë. Helvetët u eliminuan vetëm pas goditjes së 11-metërshave, teksa edhe njëherë tjetër, mesfushori me origjinë shqiptare ishte nga më të mirët në fushë, pavarësisht se luajti me një problem muskolor. Bukayo Saka deklaroi se e admironte së tepërmi Granit Xhakën, duke theksuar se ai ishte një njeri i mrekullueshëm.



"Graniti ka fituar shumë trofe këtë sezon. Ai është një lojtar i shkëlqyer, por mbi të gjitha një njeri i mrekullueshëm. Përulësia

që tregoi pas ndeshjes kur erdhi dhe na takoi të gjithëve tregon shumë për karakterin e tij. Kam shumë respekt për Xhakën dhe

e admiroj atë dhe skuadrën e Zvicrës", u shpreh Saka, i cili më parë ka luajtur me Xhakën të Arsenal.



## Shaqiri: Shumë krenar për Evropianin e Zvicrës

**CYRIH, 7 KORRIK** - Pas eliminimit të Zvicrës në çerekfinalen e "Euro 2024" nga Anglia, Xherdan Shaqiri u shpreh shumë krenar për rrugëtimin e ekipit helvet. Duke folur për mediet pas ndeshjes që në

kohën e rregullt u mbyll me barazimin 1-1 dhe me fituesin që u vendos pas penalltive, sulmuesi deklaroi se zhvilluan një turne shumë të mirë. "Mendoj se zhvilluam një turne shumë të mirë. Jam shumë

krenar për ekipin dhe mënyrën se si luajtëm. Shpresoj se herën tjetër mund të bëjmë më mirë, por jam shumë krenar. Ishte një ndeshje e shkëlqyer nga të dyja palët. Ne kaluam në epërsi, por Anglia luajti më mirë se

ndeshjet e mëparshme. Në fund rezultati ishte 1-1 dhe ndeshja shkoi deri te penalltitë, të cilat janë gjithmonë 50-50. Anglia tregoi nerv më të mirë sot dhe fitoi", ka përfunduar Shaqiri.

## Hamiltoni triumfon në pistën Silverstone

Londër, 7 korrik - Gara e Formula 1 për Çmimin e Madh të Britanisë në pistën Silverstone na dha një spektakël të vërtetë sot dhe në garën më të mirë të sezonit fitoi piloti britanik Lewis Hamilton. Hamilton arriti kështu fitoren e tij të parë në kampionatin e Formula 1 që nga 5 dhjetori 2021, kur festoi në Arabinë Saudite dhe ky ishte sezoni i famshëm në të cilin Max Verstappen i dha fund dominimit të tij shumëvjeçar. Në fillimin e garës së sotme, George Russell mbajti pozitën e parë, Hamilton mbeti i dyti, dhe Verstappen arriti të kalojë përpara Lando Norris në pozitën e tretë dhe ky ishte ndryshimi më domethënës në xhiron e parë.



Megjithatë, Verstappen nuk mundi të gjente ritmin e duhur dhe Norris e kaloi atë në xhiron e 15-të dhe menjëherë pas kësaj të

dy drejtuesit e Mercedes gabuan në kthesën e parë dhe më pas Norris mori vendin e parë. Në atë moment filloi të bjerë shi dhe

McLaren u soll shumë më mirë në kushte të tilla, ndërsa Oscar Piastri doli në krye të renditjes. Mirëpo, Piastri ishte i fundit që ndërroi gomat kur filloi të binte shi dhe me atë rast humbi shumë pozita dhe zbriti në vendin e 6-të. Norris mbajti vendin e parë edhe në kushte shiu, Hamilton ishte i dyti dhe Verstappen i treti në xhirot në vijim, por në xhiron e 34-të Russell duhej të dorëzohet për shkak të problemeve me makinën. Shiu u ndal disa xhiro më vonë dhe pothuajse të gjithë shoferët kaluan në goma të thata në xhiron e 39-të. Norris ishte i vetmi nga kreu i renditjes që nuk e bëri këtë, një xhiro më vonë ai shkon

të ndryshojë gomat dhe bën një gabim që bën që Hamilton të zërë vendin e parë. Hamilton mbajti vendin e parë deri në fund dhe festoi fitoren pas 945 ditësh. Verstappen përfundoi i dyti me vetëm një sekondë e gjysmë prapa, pasi holandezi e kaloi Norrisin katër xhiro para fundit. Britaniku me makinën McLaren, Russel përfundoi i treti, dhe në dhjetëshen e parë ishin Piastri, Sainz, Hulkenberg, Stroll, Albon dhe Tsunoda. Verstappen mbetet lider në renditjen e përgjithshme të pilotëve me 255 pikë, Norris është i dyti me 171 pikë, Leclerc është i treti me 150 dhe Hamilton mbetet i teti pasi ka vetëm 110 pikë.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me operatorin "Sharr Cem" Sh.p.k. Hani Elezit, fabrikë për prodhimin e çimentos organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 30.07.2024, në ora: 10:00, në hapësirat e LAB (Laboratori për Aktivitete të Biznesit), Rr. Adem Jashari, Nr. 218, 71510, Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga operatori "Sharr Cem" Sh.p.k. Hani Elezit, fabrikë për prodhimin e çimentos, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Taulant Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shme "Kadri Kusari" Gjakovë.

Lendrim Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Pjeter Bogdani" Damjan KK Gjakovë nga kl. 1-9.

Veli Fetahu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën sh.m Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

